

Fondi i Qëndrueshëm Raiffeisen Solid



Raport Muaji Korrik 2025

Fondi Furnizues Raiffeisen Solid

Informacion bazë

Emri i fondit	
Administrimi i Fondit	
Monedha	Euro
Datë Lancimi	07 Maj 2024
Vlera fillestare e kuotës	100
Shuma minimale e investimit	€ 500
Shuma fillestare minimale per plan investimi	€ 50
Fondi Kryesor ku investon	Raiffeisen-Nachhaltigkeit-Solide – ISIN AT0000A1YC10
Vlera Neto e Aseteve	€ 1,831,785
Cmimi i kuotës	103.4088
Banka depozitare	Banka e Pare e Investimit, Albania
Banka nëndepozitare	Raiffeisen Bank International, Austria
Numri i Investorëve	77
Horizonti minimal i rekomanduar i investimit	5 vjet
Kthimi vjetor nga investimi në 31 Korrik 2025	+1.63%

Fondi i Qëndrueshëm Raiffeisen Solid – Fond Furnizues Shoqëria Raiffeisen Invest sh.a

Euro	
07 Maj 2024	
100	
€ 500	
€ 50	
Raiffeisen-Nachhaltigkeit-Solide – ISIN AT0000A1YC10	
€ 1,831,785	
103.4088	
Banka e Pare e Investimit, Albania	
Raiffeisen Bank International, Austria	
77	
5 vjet	
+1.63%	

Komisione dhe Tarifa

Tarifë në hyrje	0.00%
Tarifë në dalje	1.00% për çdo tërheqje përpara periudhës 2-vjeçare të investimit
Tarifë administrimi vjetore	Deri në 1.30% në vit
Tarifa te tjera te vazhdueshme	Kalkulohen ne fund te vitit kalendarik dhe perfshijne tarifën e paguar ndaj bankes depozitare, auditorit të jashtëm, autoritetit rregulator apo kostot për komunikimin e ndryshimeve në prospekt.

1.00% per vitin 2024 ne 31.12.2024
Referojuni informacionit ne deget e RBAL
Sipas kushteve të punës të palëve ndërmjetësuese dhe bankes depozitares.

Total Komisione/tarifa të vazhdueshme	1.06%
Komisione të transfertës nga shlyerja e kuotave	
Kosto të transaksioneve	

Referojuni informacionit ne deget e RBAL
Sipas kushteve të punës të palëve ndërmjetësuese dhe bankes depozitares.

Objektivi dhe Politika e investimit e Fondit Furnizues

Objektivi i Fondit Furnizues është t'ju mundësojë investitorëve të përfitojnë nga kthimi i Fondit Kryesor Raiffeisen-Nachhaltigkeit-Solide, i cili synon krijimin e të ardhurave të rregullta në një periudhë afatmesme.

Fondi Furnizues investon në kuotat e Fondit Kryesor Raiffeisen-Nachhaltigkeit-Solide të paktën 85% te aseteve. Jo më shumë se 15% e aseteve do të investohen në instrumente si depozita bankare afatshkurtar, marrëveshje të riblerjes dhe të anasjelltë të riblerjes, cash apo ekuivalentë të tij.


Profil i Riskut dhe Përfitimit

Risk i ulët

Potencial Përfitimi më i ulët

Risk i lartë

Potencial Përfitimi më i lartë



Profil i parashikuar i riskut të Fondit Furnizues eshte i lidhur ngushte me profilin e riskut të Fondit Kryesor. Bazuar në të dhënrat historike të kthimeve të Fondit Kryesor gjatë 5 viteve të fundit, profili i parashikuar i riskut të Fondit Furnizues i përket kategorisë 3 të treguesit të riskut sintetik dhe përfitimit (**SRRI=3**).

Treguesi i riskut dhe përfitimit korrespondon me një numër të plotë i cili përdoret për të renditur fondin në një nivel rishku nga 1 në 7, sipas nivelit të rritjes të luhatshmërisë. Kategoria më e ulët nuk do të thotë që investimi në fond është pa rishku. Ky tregues ka për qëllim t'ju informoje mbi luhatshmërinë e çmimit të kuotës së fondit bazuar në historikun e performancës se fondit. Të dhënrat historike të përdorura për llogaritjen e treguesit nuk mund të përbëjnë një siguri të plotë për profilin e riskut në të ardhmen

Fondi Kryesor Raiffeisen Solid

Informacion bazë

Emri i fondit	
Administrimi i Fondit	
Monedha	Euro
ISIN	AT0000A1YC10
Tarifë në hyrje	0.00%
Tarifë në dalje	0.00%
Tarifë administrimi vjetore	0.50%
Rabat i paguar Fondit Furnizues	0.306% në vit

Fondi i Qëndrueshëm Raiffeisen Solid Raiffeisen Kapitalanlage-Gesellschaft m.b.H, Austria

Politika e Investimit

Fondi Kryesor është një **Fond miks** që investon në tituj, emetuesit e të cilëve janë klasifikuar si **të qëndrueshëm në bazë të kriterieve sociale, mjedisore dhe të qeverisjes** (pa marrë parasysh investimet ne fonde investimi, instrumentet derivative dhe depozitat). Sipas këtyre kritereve, nuk investohet në sektorë të caktuar, të tillë si prodhimi i armëve, inxhinieria gjenetike e gjelbër/bimëve, në kompani që shkelin të drejtat e punës dhe të njeriut, ose që janë të përfshira në korruption dhe manipulim të pasqyrave financiare, ne shtete me regjime autoritare, ku shkëlet liria e medias dhe shtypit, apo qe nuk janë pjesë te marrëveshjes së Parisit për ndryshimet klimatike apo kanë problematika të lidhura me pastrimin e parave.

Fondi Kryesor e ka kufizuar investimin në aksione deri në 30% të aseteve të tij. Të paktën 51% e aseteve të Fondit Kryesor investohen drejtpërdrejt në tituj. Emetuesit e obligacioneve ose instrumenteve të tregut të parasë në Fond mund të janë, ndër të tjera, shtetet, organizatat supra kombëtare dhe/ose kompanitë. Fondi Kryesor mund të investojë më shumë se 35% të aseteve në tituj borxhi të emetuar nga qeveria e Austrisë, Gjermanise, Belgikës, Finlandës, Francës ose Holandës.

Fondi Kryesor mund të investojë në instrumente derivative si pjesë e strategjisë së tij të investimit, me qëllimin për të zbutur risqet dhe për të arritur objektivat e politikës së investimit.


Struktura e Portofolit të Investimit në 31 Korrik 2025

Fondi Furnizues ka investuar 99.07% të aktiveve të tij në Fondin Kryesor në 31 korrik 2025.

Duke marrë parasysh strukturën e portofolit të investimeve të fondit Kryesor më 31 korrik 2025, për fondin Furnizues alokimi në aksione është 19.5% dhe alokimi në instrumentet me të ardhura fiksë është 79%.


Vlerësimi mesatar i riskut te kreditit është A për investimet në obligacione të fondit Kryesor. Yield-i mesatar i portofolit të investimeve ishte 3.37% për një kohëzgjatje mesatare prej 5 vitesh në 31 korrik për fondin Furnizues.

Sipas instrumentave financiare



- Kuota te Fondit Kryesor
- Cash & instrumente te tregut te parase

Sipas klases se aseteve



Investimet Top 10 – Fondi Kryesor

BUNDESREPUB. DEUTSCHLAND DBR 4 01/04/37	1.54%
BPIFRANCE SACA BPIFRA 3 3/8 05/25/34	1.51%
BUNDESREPUB. DEUTSCHLAND DBR 2.6 08/15/34	1.05%
CAISSE D'AMORT DETTE SOC CADES 0 1/8 09/15/31	0.93%
REPUBLIC OF AUSTRIA RAGB 0.9 02/20/32	0.81%
SPAREBANK 1 BOLIGKREDITT SPABOL 0.01 09/22/27	0.79%
EUROPEAN UNION EU 0 07/04/31	0.77%
LAND HESSEN HESSEN 2 1/2 10/01/31	0.76%
CAISSE D'AMORT DETTE SOC CADES 0.6 11/25/29	0.69%
ERSTE GROUP BANK AG ERSTBK 0.01 07/12/28	0.64%

Info per Obligacionet – Fond Kryesor

Ø Kohëzgjatja	5.05
Ø Kohëzgjatja e modifikuar	4.90
Ø Yield në % (në maturim)	3.40
Ø Yield në % (Next call)	3.35
Ø Norma e kuponit në %	2.51

Investime ne Aksione top 10 - Fondi Kryesor

NVIDIA Corp	1.22%
Microsoft Corp	1.06%
Apple Inc	0.87%
Alphabet Inc	0.81%
Broadcom Inc	0.35%
Motorola Solutions	0.27%
Visa Inc	0.26%
Mastercard Inc	0.26%
Procter & Gamble Co/The	0.25%
Arista Networks Inc	0.25%

Vlerësimi i ndikimit

Krahasim i kompanive ku fondi investon me tregun në tërësi
I vlefshëm për segmentin e aksioneve të Fondit të Qëndrueshëm Raiffeisen Solid



27% më pak
emetime CO₂



18% më pak
akidente në punë



95% më pak
mbetje



84% më pak
konsum i ujit

Burimi: Raiffeisen KAG, Ilogaritje të datës 30 qershori 2024.

Performance e Fondit Furnizues

Fondi Furnizues ka shënuar një ecuri pozitive mujore prej **0.88%** gjate muajit korrik.

Yield-et e obligacioneve të qeverisë u rritën, pas optimizmit të shtuar në lidhje me rritjen ekonomike, por gjithashtu në përputhje me shqetësimin e konsiderueshëm të tregjeve mbi situatën fiskale. Tregjet e obligacioneve të korporatave shijuan një muaj pozitiv, duke gjeneruar kthime pozitive mbi obligacionet qeveritare. Tregjet e aksioneve u mbështetën nga progresi me tarifat, fitimet e mirëpritura të korporatave dhe entuziazmi i vazhdueshëm mbi investimet në intligencën artificiale.

Duhet patur parasysh se norma e kthimit ndryshon ne varesi te kushteve te tregut dhe çmimi i kuotës mund të jetë i luhatshëm, pra nuk është statik apo gjithmonë në rritje, por edhe mund të bjerë si pasojë e ndryshimeve të kushteve në treg. Luhatshmëria është pjesë e natyrshme e fondevë te investimit dhe eliminimi total i saj është i pamundur.

Investitorët e fondit të Qendrueshem Raiffeisen Solid dhe te gjithe fondevë te administruara nga Raiffeisen Invest keshillohen te kene një horizont sa me te gjate investimi per te perfituar një kthim optimal nga investimi dhe ne kete menyre ne periudhe afatmesme apo afatgjate te kene mundesi te rikuperojne edhe efektet negative te krijuara afatshkurter.

Investitorët inkurajohen qe te ruajne investimin e tyre duke mos ndryshuar objektivin e qendrimit ne fond te nxitur nga situatat jo te zakonshme te krijuara perkohesisht në tregjet financiare, sepse ne kete menyre nuk do te rishkojne te dalin nga fondi ne momentin e gabuar per investimin e tyre.

Komenti i Menaxherit të fondit Kryesor mbi zhvillimet e tregjeve financiare gjatë Korrikut

Tregjet ndërkombe të kapitalit kanë performuar shumë mirë në korrik. Kjo ndodhi për shkak të përparimit në negociatat mbi tarifat dhe një fillimi solid të sezonit të raportimeve në SHBA. Obligacionet ishin relativisht të dobëta në korrik. Qasja e paqartë e kohëve të fundit e SHBA-së ndaj politikës tregtare, i la vendin një kursi disi më të moderuar. Obligacionet e korporatave gjithashtu performuan pak më mirë, pjesërisht për shkak të një mqedisi të qëndrueshmërit me rritjeje në tremujorët e ardhshëm. Në këtë mqedis, foni pati një performancë lehtësisht pozitive.

Fondi kryesor investon duke siguruar diversifikim të gjerë në obligacione dhe aksione të kompanive dhe qeverive që respektojnë kriteret e qëndrueshmërisë.

Zhvillimet në muajt e ardhshëm do të varen kryesisht nga politika tregtare e SHBA-së, masat e mëtejshme të bankave qendrore dhe sezioni i raportimeve.

Të dhënët e kthimit nga investimi në të shkuarën janë vetëm ilustrative nuk përfaqësojnë një premtim apo garanci për kthimin në të ardhmen. Të gjithë shembujt e tjerë numerikë janë përdorur për qëllime ilustrative dhe analize të të dhënave historike, dhe nuk duhen përdorur nga investitorët për të nxjerrë konkluzione për të ardhmen.

Investitorët e mundshëm duhet të lexojnë Prospektin dhe Rregullat e Fondit Furnizues. Raiffeisen Invest dhe forca shitëse e fondit nuk garantojnë një kthim të caktuar të fondit.

Informacioni mbi çmimin e përditësuar të kuotës, prospektin dhe rregullat e Fondit Furnizues gjendet pranë zyrave të Raiffeisen Invest sha., në web site www.raiffeisen-invest.al ose në degët e Raiffeisen Bank në Shqipëri.

Dokumentacionin e fondit Kryesor mund ta gjeni në gjuhën angleze dhe gjermane duke klikuar si më poshtë:

<https://www.rcm.at/at-en/retail/funds/detail/Raiffeisen-Nachhaltigkeit-Solide>

<https://www.rcm.at/at-en/retail/funds/detail/Raiffeisen-Nachhaltigkeit-Solide>